



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.462/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm Dylberizm, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjekti Politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 11.02.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar ankesa** Anr.462/2025 e datës 08.02.2025, e parashtruar nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datë 08.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, më të cilën pretendohet se me 6 dhe 7 shkurt, gjatë fushatës zgjedhore, subjektit politik Koalicioni për Familje në Viti dhe Prishtinë, ka publikuara ngjarje me transmetime live në rrjetin social Facebook, po ashtu dhe në postime tjera, subjekti politik ka bërë deklarata që përmbajnë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standardet ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Me tutje ne ankesë pretendon se deklaratat janë bërë nga kandidatët për deputet nga radhët e subjektit në fjalë, Eman Rrahmani dhe Milaim Sylejmani, si dhe duke përfshirë dhe elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejte ndaj një komuniteti të caktuar. Po ashtu në ankesë theksojnë se në një video tjetër, të publikuar në po të njëjtën datë në faqen e subjektit politik, vërehet se

Koalicioni për Familje e ka shkelur Kodin e Mirësjelljes duke i ekspozuar fëmijët në kuadër të fushatës zgjedhore.

Në fjalimin përmbyllës i publikuar drejtpërdrejt në faqen e Koalicionit për Familje, kandidati Eman Rrahmani ka deklaruar:

"Është krijuar nga nevoja për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla, është filluar nga nevoja për ruajtjen e dinjitetit të grave dhe nanave tona, është filluar për shkak të nevojës të shkaktuar prej cenimit nga ata që për qëllim kanë interesat e tyre financiare, karrierën e tyre profesionale punojnë ditë e natë edhe kundër vetë familjeve të tyre kundër fëmijëve të tyre dhe kundër të ardhmes së tyre vetëm e vetëm që t'i plotësojnë epshet e tyre dhe t'i plotësojnë nevojat e tyre të cilat as nuk janë të drejta, as nuk janë njerëzore e as nuk e shpieren askund këtë vend tonin"

Po ashtu në ankesë pretendojnë se deklarata e tillë është stigmatizuese, e cila i zhvesh personat LGBTI+ nga njerëzorja, pra i dehumanizon ata me shprehjen "nevojat e tyre të cilat as nuk janë të drejta, as nuk janë njerëzore". Andaj Synimi i kësaj deklarate është që ta shpallë komunitetin LGBTI+, kërkesat të tyre, si jonjerëzorë ose më pak njerëzore sesa personat heteroseksualë. Si dhe i paraqet personat LGBTI+ si kundërshtarë të familjeve shqiptare.

Me tutje në ankesë pretendojnë se kjo deklaratë përmban përdorim të dezinformimit dhe gjuhës nxitëse të drejtpërdrejt ndaj organizatave dhe individëve që mbështesin të drejtat e personave LGBTI+ dhe paraqet një prej deklaratave më të rrezikshme që nxit frikë të komuniteti LGBTI+ dhe mund ta nxisë dhunën ndaj tij gjithashtu ankesës ia ka bashkangjitur edhe disa deklarata të personave të ndryshëm. Me ane të së cilave pretendojnë se me këto veprime është shkelur neni 34 i LZP-se.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur linkun e postuar në facebook lidhur me deklaratat në fjalë

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid02WoyY5WJMw5zNYVKzn5DmubQr7vCryvvyZTrz9Sbznq8QnXCcpp39yb9GCbfnu35jTvl&id=100090563507787](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02WoyY5WJMw5zNYVKzn5DmubQr7vCryvvyZTrz9Sbznq8QnXCcpp39yb9GCbfnu35jTvl&id=100090563507787)

Milaim Sylejmani deklaron:

"Nuk do t lejojmë që nderi jonë i cili është larë me gjakun e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me vuajtjet dhe persekutimet të cilat i kanë pasur të burgosurit politikë të jetë pjesë e nëpërkëmbjes së nderit tonë për interesa mesquine të qarqeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit"

Deklarata paraqet sulm drejtpërdrejtë kundër të drejtave të personave LGBTI+ dhe nxit diskriminim dhe armiqësi ndaj tyre, duke krijuar një klimë frike edhe për mbështetësit e të drejtave LGBTI+, pasi kandidati sugjeron se personat LGBTI+ po shkojnë kundër gjakut të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Përdorimi i termit "interesa mesquine" dhe referenca e qarqeve të jashtme e të brendshme e rëndojnë edhe më shumë peshën stigmatizuese të deklaratës për personat LGBTI+. Deklarata e Milaim Sylejmanit shkon kundër atmosferës zgjedhore ku mbretëron sundimi i ligjit, respekti dhe gara zgjedhore e drejtë dhe demokratike.

Vegza:<https://www.facebook.com/permalink.php?storyfbid—pfbid02irh66ZDemTCOmPfWB5kRaxVNiW8EG8UE3B8iet6NRtZw9cn33v7ySYyhayPS5iAAI&id=61572416523061>

Deklarata e evidentuar:

Në fundin e videos së shkurtër kandidati Eman Rrahmani, pasi fillimisht i referohet Kodit Civil, për të cilin thotë se lejon martesat mes seksit të njëjtë, deklaroi se:

"Jemi t'vetmit që nuk keni pranuar atyre agjendave me ju nënshtrë. Andaj nga këtu ju them që do t'na keni krah të fortë edhe në institucione edhe kudo që mos t'lejojmë kurrë më Dokufesta të tillë. Na jemi për Dokufesta ku mësohet tradita jonë. Ku mësohet vlera jonë. Ku mësohet kultura, ku mësohet nderi, ku ruhet familja, jo për Dokufesta të cilët provojnë që fëmijët tonë me na i degjenerua. Nuk do t'lejon. Asnjëherë!" Kjo deklaratë nxitëse, në videon e shpërndarë, kandidati i Koalicionit për Familje shënjestrën komunitetin LGBTI dhe mbështetësit e tij, duke i fajësuar ato për tentim për "Ti degjeneruar" fëmijët. Kjo paraqet edhe dezinformim të publikut me qëllim të avancimit të fushatës zgjedhore dhe përsëritje të shkeljeve të mëparshme. Ky formulim përmban gjuhë që synon të portretizojë individët dhe organizatat LGBTI+, si dhe organizimin e aktiviteteve kulturore vetdijësuese, si në këtë rast nga Dokufest, si armiq të "familjes" dhe si shkaktarë të dëmtimit të saj. Efekti i saj është krijimi i ndjenjës së frikës dhe urrejtjeje ndaj grupeve të caktuara shoqërore.

Më tutje në ankesë përcakton Shkeljet Ligjore të dhe atë: ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Neni 34 i Ligjit për Zgjedhjet ndalon qartë përdorimin e gjuhës që nxit urrejtje ose provokon akte dhune. Deklaratat e kandidatëve përmbajnë elemente që përçajnë qytetarët dhe nxisin urrejtje ndaj komunitetit LGBTI+, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ky ligj përcakton parandalimin dhe luftimin e diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Deklaratat e kandidatëve përbejnë gjuhë diskriminuese dhe krijojnë një ambient armiqësor që cenon parimet e barazisë dhe trajtimit të drejtë. Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike. Neni 4 i Kodit përcakton që subjektet politike dhe kandidatët e tyre duhet të shmangin gjuhën diskriminuese dhe përçarëse. Deklaratat e kandidatëve bien ndesh me këto standarde, duke përçarur një mesazh të urrejtjes dhe diskriminimit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës Kushtetuta garanton të drejtën për trajtim të barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

PZAP me datë 10.02.2025 i ka dërguar kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicioni për Familje deri me datën 11.02.2025 në ora 09:00 dhe të njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje.

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës vlerësoj se pretendimet e Organizatës Joqeveritare CEL Kosova dhe Dylberizim janë të pa qëndrueshme, pasi që deklaratimet dhe gjuha e përdorur gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni për Familje nuk përbejnë shkeljen e pretenduar.

Nga vlerësimi i provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës në fjalimet e kandidatëve të subjektit politik Koalicioni për Familje të cilat fjalimet janë paraqitur të shkruara sim ë lartë dhe në linqet përkatëse, Paneli ka vlerësuar se të njëjtit nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, përkatësisht nenit 34 par.1 pika 1.11 të LZP-së. Kjo pasi që këto deklarime në asnjë rast nuk janë drejtuar ndaj një subjekti, komuniteti apo grupacioni të caktuar dhe nuk ka pasur thirrje apo nxitje të dhunës apo urrejtjes, për të ndërmarrë veprime kundër komuniteteve të caktuara, siç pretendohet në ankesë.

Sipas bindjes se panelit gjuha e përdorur në fjalimet e kandidateve të lartcekur nga subjekti politik Koalicioni për Familjen ka të beje me shpalosjen e programit e tyre elektorale, në suaza të lirisë së shprehjes dhe nuk ka nuanca të gjuhës së urrejtjes.

Sa u përket pretendimeve ankimore se në tubimet elektorale të koalicionit për familjen janë përdorur fëmijët, sipas vlerësimit të panelit nuk ka prova që vërtetojnë një gjë të tillë, nga se ankesës nuk i ishte bashkangjitur asnjë foto, ndërsa në linkun e paraqitur në ankesë rezultoi se ishte joaktiv.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga mos ofrimi i asnjë provë apo dëshmie parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur ndonjë shkelje që bie në kundërshtim me dispozitat e LZP-se, pasi që ankesa e parashtruesit nuk ka qenë bindëse, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 117.3 dhe nenit 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A.nr.462/2025, datë: 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.